



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
BORDI DREJTUES

Nr. 173/3 Prot.

Tiranë, më 08.09 2025

VENDIM

Nr. 07 Datë 08.09.2025

PËR

“MIRATIMIN E UDHËZUESIT “MBI RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR.440, DATË 19.07.2023 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, I NDRYSHUAR, ME QËLLIM GARANTIMIN E SKEMËS SË KREDITIMIT STUDENTOR””

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në gërmën “c”, të pikës 1 të nenit 11, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në gërmën “c”, të pikës 3 dhe gërmën “d”, të pikës 6 të Vendimin nr.397, datë 3.5.2017 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)”, në Vendimin Nr.440, datë 19.07.2023, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e Skemës së Kreditimit Studentor”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi rregullat dhe procedurat për zbatimin e vendimit nr.440, datë 19.07.2023 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, me qëllim Garantimin e Skemës së Kreditimit Studentor, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI
Erzen TOLA

ANËTARËT

Besmir DITAJ

Artan HOXHA

Agron KASAP

Spiro BRUMBULLI